REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Date 13/02/2026.

Lenda : Relacion për Projekt Vendimin Nr.2 Date 13.02.2026,"NJE SHTESE NE BUXHETIN E BASHKISE HAS PER VITIN 2026 (AKT TRASHEGIMIA 2025 NE BUXHETIN 2026)

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", paraqitet për miratim shtesa e fondeve në buxhetin e vitit 2026, si rezultat i fondeve të trashëguara nga viti buxhetor 2025.

Pas rakordimit me Degën e Thesarit Has, rezulton se Bashkia Has ka trashëguar fonde në vlerën totale **24,350,348 lekë**, të ndara si më poshtë:

- 17,350,992.13 lekë – Transferta e pakushtëzuar (trashëguar nga 2025)
- 6,999,356 lekë – Të ardhura të veta të trashëguara nga viti 2025

Këto fonde parashikohet të shpërndahen në shpenzime për:

- Likuidimin e detyrimeve të prapambetura (kolaudime, supervizime, punime investimesh)
- Vijimin e projekteve investuese në proces
- Shpenzime kapitale për infrastrukturë rrugore dhe arsimore
- Transferte kapitali
- Shpenzime sociale
- Pagesa paga dhe sigurime shoqërore nga të ardhurat e veta

Ky rishpërndarje siguron:

- Vijimësinë e projekteve investuese pa krijuar detyrime të reja të prapambetura
- Likuidimin e angazhimeve kontraktore ekzistuese
- Stabilitet financiar dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor buxhetor

Miratimi i këtij projekt-vendimi është i domosdoshëm për reflektimin në sistemin AFMIS dhe për vijimin normal të ekzekutimit të buxhetit 2026.

Për sa më sipër, fondet janë alokuar në mënyrë të tillë që të likuidohen të gjitha proçedurat e mbartura nga viti 2025 (si rezlutat të ulet risku i shtimit të detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Has për vitin 2025) dhe gjithashtu diferenca e mbetur është alokuar në investime dhe shpenzime me rëndësi strategjike për Bashkine Has.

Faleminderit per bashkepunimin.

Konceptoi:

Grislanda Bajraktari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Has,me 13/02/2026

PV. 03

Lënda: Relacion "Për përcaktim përdorimi fondi (Grand Performance), me burim financimi të huaj".

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", Udhëzimit të përbashkët nr. 20 & 01, datë 11.07.2025, mbi shpërndarjen e fondit të grantit të bazuar në performancë (GBP), paraqitet për miratim përdorimi i fondit të përfituar nga Bashkia Has me kapitull financimi te huaj.

Sipas njoftimit zyrtar të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), Bashkia Has është shpallur përfituese e fondit në vlerën: **5,999,903.21 lekë.**

Ky fond është me burim financimi të huaj dhe do përdoret për shpenzime kapitale (pa përfshirë paga dhe shpërblime).

Propozohet që fondi të destinohet për projektin:

"Rehabilitim, sistemim, asfaltim Rruga Bregu i Vlahnes – Nikoliq", Njësia Administrative Golaj

Ky investim synon:

- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore rurale
- Rritjen e aksesit për banorët dhe aktivitetet ekonomike
- Përmirësimin e sigurisë dhe cilësisë së jetës

Miratimi i këtij vendimi mundëson regjistrimin e fondit në kapitullin 02 (financim i huaj), llogaria ekonomike 231 dhe nisjen e procedurave për zbatimin e projektit.

Konceptoi:
Grislanda Bajraktari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Lënda: Relacion PV Nr.5 të miratohet fondi ndihmë emergjente.

Ky projekt-vendim hartohet në mbështetje të", Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026". VKB Nr.109 date 24.12.2025 Për Buxhetin e Bashkisë Has.

Qëllimi i projekt-vendimit:
Ky projekt-vendim në funksion te ndihmave te menjehershme financiare per individe ne kushte te veshtira familjare, financiare dhe shendetesore.

Referuar projekt vendimit pagesa e ndihmave do te kryhet nga Fondi Rezerve i Buxhetit të Bashkisë Has me sistemimet e duhura pakësime -210,000 Lekë dhe te zeri Ndihma Financiare sektori i perkujdesjes sociale dhe ekonomike ne llogarine 6061041 shtesa 210,000 Lekë për të procesuar edhe transfertën e ndihmës të këto individë bazuar te kushtet dhe kriteret të përballimit të nevojave të tyre.

Miratimi i këtij projekt-vendimi mundëson:
Përdorimin me eficiencë të fondeve publike.
Përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe financiare të Bashkisë Has për vitin 2026.

Përgjegjëse Finance

Grislanda Bajraktari

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE I PËRKUJDESJES SOCIALE

Krumë me 10.02.2026

Relacion

Për
Përdorimin e fondit të kushtëzuar për Bllok-Ndihmën deri në 6% për muajin Janar 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.9.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Sociale ka shqyrtuar dhe përpunuar aplikimet për përfitim nga fondi shtesë deri në masën 6% për muajin Janar 2026, dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ka kryer përzgjedhjen sipas prioriteteve dhe dokumentacionit të paraqitur në dosje.

Fondet në dispozicion për muajin Janar 2026, sipas Vendimit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, gjithsej **188 familje**, me një fond total prej **889.132 lekë janë si më poshtë:**

- **Krumë:** 61 familje, me fond mujor **277.201 lekë.**
- **Njësia Administrative Golaj:** 63 familje, me fond mujor **319.486 lekë**
- **Njësia Administrative Fajza:** 47 familje, me fond mujor **212.354 lekë**
- **Njësia Administrative Gjinaj:** 17 familje, me fond mujor **80.091 lekë**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, janë marrë vendimet si më poshtë:

1.Fajza : Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike-

Shtohet ne fondin 6%:

- **Vezir Ramadan LLeshi**

2.Golaj Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike

- Kade Hajdar Mulaj -Perseritje Aplikimi
- Naim Rexh Peca - Perseritje Aplikimi
- Sevdije ragip Lushi -Perseritje Aplikimi
- Zade Metush Gjoni -Perseritje Aplikimi
- Safete Tahir Osmanaj -Perseritje Aplikimi
- Pellumb Sherif Gradica -Perseritje Aplikimi
- Ardiana Ahmet Ukaj -Perseritje Aplikimi

Shtohet ne fondin 6%:

- Xhem Osman Kastrati
- Xufe Daut Sokoli
- Aurel Osman Gradica
- Elsa Sahit Ahmataj
- Man Abdi Dauti
- Ahmet Mustaf Kovaçi

3.Gjinaj :

Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike

- Mehdi Thaçi -Perseritje Aplikimi
- **Shtohet ne fondin 6%:**

4.Njesia Krume

Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike

- Albert Halit Qema - Perseritje Aplikimi

Shtohet ne fondin 6%:

P/Sek/Nd/Ekonomike

Dritan ÇERKEZI

Dritan cerkezi

Digitally signed by Dritan cerkezi
Date: 2026.02.10 09:31:07 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
Urbanistika

RELACION

PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË TË BASHKISË HAS.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Has

- BAZA LIGJORE

Mbështetur në nenin 8 pika 2, nenin 24 pika 1, nenin 64 pika c, të ligjit Nr. 139/2015, "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE"; nenin 3/1-b, nenet 4, 5 , 13, 14, 15⁶, 16 ª - b- xiv, 24 dhe nenin 30, të ligjit **Ligji Nr.22/2018 "Për strehimin social"**; VKM nr.814, datë 03.12.2004, "Për Normat e Strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit"; VKM nr.574, datë 29.08.2012, "Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore"; VKM Nr. 1093, datë 28.12.2015 "Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit"; udhëzimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit VKM nr.23, datë 30.12.2008, për "Përmbajtjen e bonusit të strehimit"; Sektori Urbanistikes, Strehimit dhe Shërbimit Social.

Theksojmë se ,bazuar në legjislacionin në fuqi ,përfitojnë bonus strehimi nga buxheti i shtetit , kategoritë e familjeve të parashikuara në nenin 46 , të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" të cilat janë : kryefamiljarët me aftësi të kufizuara ; individë me status të jetimit ; kryefamiljarët e vetëm me fëmijë ; familjet njëprindërore ; vajzat nena ; familjet qw trajtohen me ndihme ekonomike; familjeve që kanë në përbërjen familjare persona me aftësi të kufizuar dhe invalidë, familjet që trajtohen me ndihme ekonomike si dhe familjet me te ardhura mujore të ulëta . Kusht për përfitimin e fondit të bonusit të qirasë nga buxheti i shtetit është që familjet që do të trajtohen me bonus qiraje, duhet të mbulojnë pjesën e mbetur të qerasë me të ardhurat e tyre ,ose nëpërmjet financimit të bashkisë (sipas tabelës bashkëlidhur relacionit). Komisioni i Strehimit i mbledhur me datë 21.01.2025 pasi mori në shqyrtim të gjitha kërkesat e bëra për bonus strehimi, rezultoi se mbas shqyrtimit të kërkesave u kualifikohen 96 familje, ndërsa 17 kërkesa u s'kualifikuan për mungesë dokumentacioni ose që nuk plotësonin kushtet ligjore për t'u trajtuar me bonus qiraje . Kërkojme nga ana juaj miratimin e listës së familjeve të përbërë nga 96 familje që u kualifikuan nga Komisioni i Strehimit . Bashkëlidhur lista e familjeve përfituese .

Relatori: **Besart Hoxha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCAT CIVILE

Nr.64 Prot.

Krumë, me 16.02.2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK HAS

PËR

Rishqyrtim për miratim të kërkesës së qytetarit z. Mustaf Ahmet Xhafa, së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare, banesa e të cilit është dëmtuar nga reshjet e shiut **dhe erërat e forta** (kerkesë e ardhur nga Prefektura Kukës).

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" Neni 30 shkronja "gj", VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

Bazuar në kerkesat e ardhura nga qytetari, Prefektura si dhe Avokati i Popullit ku kerkojnë që të riparaqitet dosja pranë Këshillit Bashkiak për rishqyrtim dhe miratim në ***Fshatin Nikoliq, Njësia Administrative Golaj,*** **Bashkia Has**, ***nga Buxheti i Bashkisë Has për vitin 2026,*** *pasi me Vendim Nr.42 datë 31.05.2023 është miratuar Projekt-Vendimi per miratimin e demit të ketij shtetasi nga Këshilli Bashkiak Has, por me Nr.2/20 Prot, date 14.06.2023 ky Vendim është kthyer për arsye pasi "Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i mëparshëm bashkiak ushtron kompetenca të kufizuara dhe merr vendime vetëm në raste te situatave emergjente".*

Bashkangjitur ketij relacioni keni dhe kthimin e vendimit me numer rendor 7 datë 14.06.2023, nga Prefekti i Qarkut Kukës.

	Emri, Atësia, Mbiemri	Lloji i Fatkeqësisë	PREVENTIVI	Masa e Kompensimit
1	Mustaf Ahmet Xhafa	Fatkeqësi Natyrore		

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has, Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

	PREVENTIV NDËRTIMI		1,002,249 Lekë	50%	501,124.5 Lekë
	TOTALI				**501,124.5 Lekë**

Vlera totale e preventivit të banesës për të cilën ka për të marrë qytetari z.Mustaf Ahmet Xhafa është **501,124.5 Lekë**.

Përgjegjësi i Emergjencave Civile

Fatos Ahmati

Sektori Juridik

Erisa FERIZOLLI

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

Arbërie Rada

KRYETARI

Miftar DAUTI

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22040, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLIT VENDOR RINOR

Nr.766/1 Prot.

Krumë, me 25/02/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK HAS

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Has së bashku me kërkesen e nxënësve te Gjimnazit "Skenderbeu" për akordimin e ndihmës financiare për projektin e punuar nga nxënësit , ky projekt do shërbejë për blerjen e materialeve ndihmëse..

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore".

"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e hargjimeve të projektit "Bibliotekë e Hapur", kërkojmë:

Miratimin e dëmshpërblimit për projektin në fjalë, blerje mikrobitash që do i vijë në ndihmë projektit të prezantuar nga nxënësit e Gjimnazit "Skënderbeu", **Bashkia Has. nga Fondi për Aktivitet Kulturiore Sociale .**

Bazuar në kërkesën e nxënësve te gjimnazit " Skenderbeu" . drejtuar Bashkisë Has (Këshilli Vendor Rinor) për të ndihmuar grupin e nxënësve ,për ti mbështetur në blerjen e materialeve që do ju shërbejë për projektin e tyre.Nga ana e jonë në bazë të urdhërit të ngritur dhe të rishkikuar me Grupin e KVR-së dolem në këto përfundime si me poshtë:

- **Blerje Materialesh për projektin "Bibliotekë e Hapur" .**

	Emri, Atësia, Mbiemri	Lloji i Fatkeqësisë	PREVENTIVI	Masa e Kompensimit
1	Nxënësit e gjimnzait "Skenderbeu"	Projekt		
	PREVENTIV NDËRTIMI		20,000 Lekë	100% 20,000 Lekë
	TOTALI			**20,000 Lekë**

Vlera totale e preventivit të projektit të "Nxënësve të gjimnazit "Skenderbeu", është me vleren 20,000 lekë.

Sektori Juridik

Erisa FERIZOLLI

Drejtoresha e Mbrojties Civile

Arbërie Rada

KRYETARI

Miltar DAULL

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Bashki Has,
Tel/Fax.: +355 274 22060, E-mail: ...

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLIT VENDOR RINOR

Nr.766/1 Prot.

Krumë, me 25/02/2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK HAS

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Has së bashku me kërkesen e nxënësve te Gjimnazit "Skenderbeu" për akordimin e ndihmës financiare për projektin e punuar nga nxënësit , ky projekt do shërbejë për blerjen e materialeve ndihmëse..

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore",

"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e hargjimeve të projektit "Mikrobitat"", kërkojmë:

Miratimin e dëmshpërblimit për projektin në fjalë, blerje mikrobitash që do I vijë në ndihmë projektit të prezantuar nga nxënësit e Gjimnazit "Skënderbeu", **Bashkia Has**, **nga Fondi për Aktivitet Kulturiore Sociale .**

Bazuar në kërkesën e nxënësve te gjimnazit " Skenderbeu" , drejtuar Bashkisë Has (Këshillit Vendor Rinor) për të ndihmuar grupin e nxënësve ,për ti mbështetur në blerjen e materialeve që do ju shërbejë për projektin e tyre.Nga ana e jonë në bazë të urdhërit të ngritur dhe të rishkikuar me Grupin e KVR-së dolem në këto përfundime j si me poshtë:

- **Blerje Mikrobitash .**

	Emri, Atësia, Mbiemri	Lloji i Fatkeqësisë	PREVENTIVI	Masa e Kompensimit
1	Nxënësit e gjimnzait "Skenderbeu"	Projekt		
	PREVENTIV NDËRTIMI		30,000 Lekë	100% 30,000 Lekë
	TOTALI			**30,000 Lekë**

Vlera totale e preventivit të projektit të "Nxënësve të gjimnazit "Skenderbeu", është me vleren 30,000 lekë.

Sektori Juridik

Erisa FERIZOLLI

Drejtoresha e Mbrojties Civile

Arbëric Rada

KRYETARI

Miftar DAUTI

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Pogdani", Qyteti Krujë, Rrethi Has.
Tel/Fax.: +355 214 22080. E-mail: zefcivilhas@yahoo.com